

Handwritten note: "Kushti i ligjit, shprehur..."



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA PËR EVROPËN DHE PUNËT E JASHTME

Nr. \_\_\_\_\_ prot. 596/1

Tiranë, më 15.01.2018


Raport mbi veprimtarinë e Njesisë Përgjegjëse për sinjalizimin në Ministrinë  
për Evropën dhe Punët e Jashtme

Në funksion të zhvillimit të mëtejshëm të vendit dhe plotësimit të pritshmërisë së publikut dhe partnerëve ndërkombëtare, qeveria shqiptare ka ndërmarrë një përpjekje serioze në luftën kundër korrupsionit e cila përfshin një qasje të trefishtë parandaluese, ndëshkuese dhe ndërgjegjësuese.

Mështetur në këto qëllime kryesore janë përcaktuar objektivat dhe masat konkrete që duhen ndërmarrë për arritjen e tyre, duke përfshirë këtu edhe përgatitjen e një sërë aktesh ligjore dhe nënligjore që ndihmojnë këtë proces.

Në këtë kontekst është hartuar dhe miratuar Ligji Nr.60/2016 “ Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve », si një mjet i rëndësishëm antikorrupsion. Në zbatim të këtij ligji, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme me urdhërin e Ministrit nr.456, datë 25.04.2016 ka ngritur Njësinë Përgjegjëse si organi i posaçëm, i përbërë nga dy punonjës dhe i ngarkuar me detyrën e shqyrtimit të hetimit administrativ të sinjalizimit dhe shqyrtimin e kërkesës për mbrojtjen e sinjalizuesit, sipas përcaktimeve të ligjit.

Gjithashtu në zbatim të Ligjit Nr.60/2016 “ Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve “pika 10, Neni 13, ku citohet “Çdo organizatë, sipas udhëzimeve të ILDKPKI-së, dhe ILDKPKI-ja, miratojnë rregullore të brendshme të posaçme për procedurën e shqyrtimit të hetimit administrativ të sinjalizimit dhe mekanizmat e mbrojtjes së konfidencialitetit, sipas



*këtij ligji*“, Njësia Përgjegjëse në Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme ka hartuar rregulloret si më poshtë :

1. Rregullore për hetimin administrativ të sinjalizimit dhe mbrojtjen e konfidencialitetit në MEPJ.

2. Rregullore për hetimin administrativ të kërkesës së sinjalizuesit për mbrojtjen nga hakmarrja në MEPJ.

Rregulloret janë miratuar nga Ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme duke nxjerrë aktet administrative përkatëse.

Për sa i takon rasteve konkrete ju informojmë që gjatë vitit 2017 në MEPJ nuk është regjistruar ndonjë sinjalizim për akte korruptive aktive ose pasive, shpërdorim të detyrës ose kompetencave, shpërdorim të fondeve buxhetore apo çdo lloj forme tjetër të ngjashme korruptive me ato që cituam më lart.

---

---

---

---

---